

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

Zgjidhjet

P4



FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 03.02.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
1. Problemi 1	15	
2. Problemi 2	7	
3. Problemi 3	10	
4. Problemi 4	8	
5. Problemi 5	5	
6. Problemi 6	5	
7. Problemi 7	10	
Total	100	

1. Malsin Krasniqi në muajin Dhjetor 2017 ka pasur rrogën Bruto prej 650.00 Euro. Në Janar të vitit 2018, menaxhmenti vendosi që paga e Malsinit të rritet për Neto vlerë prej 36.00 Euro. Sa do të jetë paga Bruto në Janar të vitit 2018 për Malsinin?
 - a) 687.80 Euro;
 - b) 686.00 Euro;
 - c) **692.10 Euro;**
 - d) 684.20 Euro.

2. Fature në vlerë prej 770.00 Euro (përfshirë Tvsh) që është kalkulur gabimisht me Tvsh prej 16% duhet te korigjohet me normën standarde. Në të njëjtën ditë është kthyer edhe një pjesë e mallit në këtë faturë i cili kthim poashtu duhet rregulluar ne faturë. Malli i kthyer ka pasur kosto 120.00 Euro. Sa duhet të jetë vlera e faturës përfshirë Tvsh me norme standarde 18% pas korigjimit?
 - a) 650.00 Euro;
 - b) **641.67 Euro;**
 - c) 767.10 Euro;
 - d) 783.27 Euro.

3. Kompania "ART", në Tetor pranon një notë kreditore nga kompania "TRA" për blerjet të cilat i ka bërë para dy muajve nga kjo e fundit. Nota kreditore e pranuar nga "TRA" është në vlerë 1,900.40+Tvsh 18%. Për kompaninë "ART" kjo notë ka ndikim që:
 - a) Zvoglon blerjet, rrit Tvsh e zbritshme;
 - b) **Zvoglon blerjet, rrit Tvsh e llogaritur;**
 - c) Zvoglon shitjet, rrit Tvsh e zbritshme;
 - d) Zvoglon shitjet, rrit Tvsh e llogaritur.

4. Kompania "TONI" importon mall nga Austria. Vlera e faturuar nga kompania austriake është 7,000 Euro. Kosto e transportit nga Austria në Kosove është 800 Euro. Autoritet doganore kanë bërë rivlerësim të mallit për të cilën kanë vendosur bazën doganore në vlerë prej 10,000 Euro (pra rivlerësim prej 2,200 Euro). Poashtu sipas kalkulimeve në Dokumentin Unik Doganor (DUD) kjo bazë i nënshtrohet normës 10% taksë doganore dhe 18% Tvsh. Kompania "TONI" e ka pranuar bazën e paraqitur nga Dogana. Sa duhet të jetë kosto e blerjes që do të vendoset si stoqe/mall në librat e kompanisë "TONI"?
 - a) 8,580.00 Euro;
 - b) 10,124.40 Euro;
 - c) 11,000.00 Euro;
 - d) **8,800.00 Euro.**

5. Qiradhënësi, një biznes tregtar, lëshon faturën për një pasuri në baza mujore qiramarrësit "TROJA" shpk. Vlera e faturës është 800.00 plus Tvsh. Sa duhet të **pagujë** qiramarrësi "TROJA" shpk për këtë faturë Qiradhënësit. Fatura është subjekt i tatimit të qirasë sipas normës së aplikueshme të ligjit në Kosovë.
- a) 944.00 Euro;
 - b) 859.04 Euro;
 - c) 866.06 Euro;
 - d) **872.00 Euro.**
6. Një tatimpagues që të tatimohet në baza reale dhe që ai tatimpagues të konsiderohet person i tatueshëm për Tvsh, (përveq nëse regjistrohet vullnetarisht) duhet të arrijë përkatësisht të kalojë pragun e të ardhurave vjetore prej :
- a) 30,000 Euro për taturje në baza reale dhe 50,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - b) 50,000 Euro për taturje në baza reale dhe 50,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - c) **50,000 Euro për taturje në baza reale dhe 30,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;**
 - d) 30,000 Euro për taturje në baza reale dhe 30,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
7. Biznesi "PULSE", person i tatueshëm, me seli në Kosovë ofron shërbime marketingu (të reklamimit të produkteve) **në Kosovë**, në vlerë të tatueshme prej 600.00 Euro për kompaninë "SWISS" që e ka selinë në Zvicër. Për këtë shërbim, kompania kosovare duhet të lëshojë faturën në total:
- a) **708.00 Euro;**
 - b) 600.00 Euro;
 - c) 508.47 Euro
 - d) 600.00 Euro me Ngarkesë të kundërt;
 - e) Asnjëra më lartë.
8. Kompania "FLATRA" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën në vlerë prej 12,380.00 (pa e përfshirë Tvsh) dhe i ka ofruar një zbritje/lirim tregtare prej 18% mbi këtë shumë. Sa do të jetë vlera totale e faturës pas zbritjes duke përfshirë edhe Tvsh me normë standarde prej 18% për furnizimin e bërë?
- a) 12,380.00 Euro;
 - b) 10,151.60 Euro;
 - c) **11,978.89 Euro;**
 - d) 14,680.40 Euro;

9. Kompania "ALFA" shet produkte dhe shërbime me norma/marzhë fitimi të ndryshme. Produktin "A" që ka kosto prej 8.50 Euro e shet me çmim 12.50 Euro, ndërsa produktin "B" që ka kosto prej 57.50 Euro e shet me çmim prej 72.00 Euro. Sipas kalkulimeve produkti A dhe B shiten me marzhë fitimi perkatëse si vijon:
- a) Produkti "A" dhe "B" me 47.06% marzhë bruto të fitimit mbi shitje;
 - b) Produkti "B" me 32.00% marzhë bruto mbi kosto;
 - c) **Produkti "A" me 32.00% marzhë bruto të fitimit mbi shitje;**
 - d) Produkti "B" me 47.06% marzhë bruto mbi kosto;
 - e) Produkti "A" me 25.22% marzhë bruto të fitimit mbi shitje;
 - f) Produkti "A" dhe "B" me 20.14% marzhë bruto mbi kosto;
10. Kompania "BAT" është biznes i cili tatohet sipas skemës reale dhe përbëhet nga 3 ortakë (Blendi, Arbeni dhe Toni) pra biznes ortakëri. Sipas legjislacionit tatimor ortakëria dhe ortakët me 31.12.2017 duhet të deklarojnë pranë ATK-se:
- a) Ortakëria deklaratën DO ndërsa ortakët se bashku një deklaratë të PD-së;
 - b) Ortakëria deklaron PD ndërsa ortakët secili DO;
 - c) **Ortakëria deklaron DO ndërsa secili ortak deklaratën e PD-së.**
 - d) Ortakëria deklaron CD ndërsa ortakët secili deklaratën DO.

1. Mospagesa e detyrimit tatimit ne kohen e parapare me ligjet tatimore, bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do te paguaje një interes prej 0.65% ne muaj apo pjese te muajit.

E saktë
E pasaktë

2. Sipas ligjit të TVSh-së, tatimi i llogaritur kuptojmë - Tvsh-në në furnizimet të cilat i bënë personi i tatueshëm ose mallrat që i eksporton personi i tatueshëm.

E saktë
E pasaktë

3. Kompania Prishtina jep me qira veturën luksoze kompanisë T nga Tirana. Kompania nga Tirana veturën e pranon në Prishtinë tek selia e kompanisë. Ky transaksion është furnizim i pa tatueshëm.

E saktë
E pasaktë

4. Sipas ligjit të Tvsh-së bizneset e huaja duhet të regjistrohen në regjistrin e detyrueshëm të Tvsh-së nga momenti i fillimit të aktivitetit të tyre në territorin e Kosovës.

E saktë
E pasaktë

5. Mospagesa e detyrimit tatimit ne kohen e parapare me ligjet tatimore, bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do te paguaje një gjobë prej 0.5% ne muaj apo pjesë të muajit, por jo me shumë se 6% (12 muaj).

E saktë
E pasaktë

6. Sipas Ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, periudha tatimore për bizneset individuale që kanë një qarkullim nën 50 000 EUR dhe që nuk janë të regjistruar në fitimin real, është çdo tremujorësh.

E saktë
E pasaktë

7. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, një tatimpagues me të ardhura vjetore bruto prej 50.000 Euro apo më pak për te zgjedhur që të përgatitin pasqyrat financiare dhe te paguaj tatim ne fitimin real duhet të dorëzojë një kërkesë për regjistrim në ATK, deri më 1 Mars të vitit aktual për të cilin tatimpaguesi kërkon te regjistrohet.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur konsiderohet shpenzim i pa zbritshëm.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas ligjit te Tvsh, çdo person është i obliguar që të regjistrohet për Tvsh nga momenti i kalimit të qarkullimit prej tridhjetëmijë Euro (30.000€), brenda vitit kalendarik dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, personi i cili është pronar i një ndërmarrje individuale, qoftë të regjistruar apo të pa regjistruar, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një ndërmarrje individuale.

E saktë

E pasaktë

11. Blerjet për të cilat një faturë është lëshuar duhet të futet në librin e blerjeve brenda 60 orëve ditëve pas pranimit të faturës së blerjes. Shitjet për të cilat një faturë e shitjes është lëshuar duhet të futet në librin e shitjeve brenda 5 ditëve pas lëshimit të faturës së shitjes.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", janë keto biznese që detyrohen të nënshtrohen auditimit vetëm nga firmat audituese të licencuar mbi kriteret e këtij ligji.

1. qarkullim vjetor (neto): më i madh se katër (4,000,000) milion Euro;
2. asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: më të mëdha se një (1,000,000) milion Euro;
3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: 10 deri në 50.

E saktë
E pasaktë

13. Sipas dispozitave të ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave shkalla në përqindje e pagesës së tatimit për kompanitë që paguajnë mbi fitimin real dhe kompanitë që paguajnë mbi qarkullimin vjetor të tyre është: 10% mbi fitimin real; 9% e primit bruto për sigurimet dhe risigurimet; 3% në qarkullim për biznese me qarkullim nga 0 – 50,000 EUR por jo më pak se 37.5 Euro.

E saktë
E pasaktë

14. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet e qirasë të një muaji përkatës të paguara në gjysmën e dytë të vitit në vijim janë shpenzime të periudhës përkatëse për qëllime tatimore duke respektuar parimin akroal.

E saktë
E pasaktë

15. Sipas Ligjit të Tvsh një biznes me rastin e përllogaritjes së pragut për regjistrim në Tvsh, personi duhet të marrë parasysh shumën totale të të gjitha furnizimeve të tija përgjatë periudhës së 12 muajve të fundit dhe kjo shumë të jete mbi 30,000 EUR.

E saktë
E pasaktë

16. Sipas dispozitave të ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave Shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për veprimtari ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periodën e kohëzgjatjes së qirasë.

E saktë
E pasaktë

17. Sipas Ligjit të Punës, Kontrata e Punës mund të lidhet për:

1. një periudhë të pacaktuar;
2. një periudhë të caktuar; dhe
3. për punë dhe detyra specifike.

18. Shkalla e akcizës që zbatohet për disa produkte ka vetëm vlerë fikse dhe nuk aplikohet shkallë e caktuar e përqindjes.

E saktë
E pasaktë

19. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, maksimumi i lejuar për pagesën e kontributit pensional punëdhënës i punësuar është 1/3 e pagës.

E saktë
E pasaktë

20. Sipas ligjit të TVSh-se, **tatimi i zbritshëm** kuptojmë - Tvsh-në në furnizimet të cilat i bëjnë personi i tatueshëm ose mallrat që i eksporton personi i tatueshëm.

E saktë
E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

15 pikë

Kompania QENDRA shpk me seli në Ferizaj kryen disa aktivitete ekonomike dhe gjatë muajit Janar 2018 ka këto transaksione: shitjet brenda vendit me norme 18% - shuma e tatushme 54,500 Euro, shërbime transportit Prishtinë - Durrës 13,200 Euro, blerjet nga bizneset të cilat nuk janë të regjistruar në Tvsh 8,020 Euro, import nga Franca (kamion) i cili nevojitet për shërbime transporti 22,300 Euro, blerje e një veture në vlerë prej 40,000 Euro nga një biznes vendor me norme 18% i cili konsiderohet si veturë luksi, notë kreditore e lëshuar me norme 18% vlera 7,700 Euro shuma e tatushme, shpenzime të rrymes ujit etj të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar 525 Euro (shuma e tatushme).

Poashtu gjatë këtij muaji ka pranuar shërbime të nga jashtë vendit në vlerë prej 1,200 Euro (ngarkesë e kundërt).

Vlerat e paraqitura janë pa përfshire Tvsh-në.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së Tvsh-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 01/2018 biznesi në fjalë duke marrë parasysh kreditimin e bartur të muajit Dhjetor prej 500 Euro.

Zgjidhje:

Ekstrakt i deklaratës mujore Janar 2018:

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH			
Periodha e Deklarimit:	Kolona [1]	01	2018
Numri Fiskal:	Kolona [3]	600700800	
Emri i biznesit:	Kolona [4]	QENDRA shpk	
Adresa e biznesit:	Kolona [5]	FERIZAJ, KOSOVË	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [6]	Fistek Filani 044/123123	
		Furnizimet Vlera	TVSH
Shitjet e liruar pa të drejtë kreditimi	Kolona [9]	-	
Shitjet e liruar me të drejtë kreditimi	Kolona [10]	13,200	
Eksportet	Kolona [11]	-	
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	54,500	9,810
Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	Kolona [28]	1,200	216
		Kolona [30]	10,026
		Blerjet Vlera	TVSH
Blerjet dhe importet pa TVSH	Kolona [31]	8,020	
Blerjet dhe importet investive pa TVSH	Kolona [32]	-	
Blerjet dhe importet me TVSH jo të zbritshme	Kolona [33]	-	
Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	Kolona [34]	23,600	
Importet investive me normë 18%	Kolona [39]	22,300	4,014
Blerjet vendore me normë 8%	Kolona [45]	525	42
Blerjet investive vendore me normë 18%	Kolona [47]	20,000	3,600
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18%	Kolona [53]	7,700	1,386
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	Kolona [65]	1,200	216
		Kolona [67]	9,258
		Kalkulimi Vlera	
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]	500	
Balanca kreditore e mbetur 69 = ((67+68)-30)>0	Kolona [69]	-	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues 71 =(69-70)	Kolona [71]	-	
TVSH që duhet të paguhet 72 =(30-67-68)>0	Kolona [72]	268	

Sqarim: Blerjet dhe importet me Tvsh jo të zbritshme :

$$\begin{aligned}
 &(40,000 \times 50\%) = 20,000 \text{ (pjesa e kostos)} \\
 &\text{plus(+)} 40,000 \times 50\% \times 18\% = \underline{3,600} \text{ (pjesa e Tvsh-së së pazbritshme)} \\
 &\text{Total} = 23,600
 \end{aligned}$$

Blerjet investive vendore me normë 18%: $40,000 \times 50\% = 20,000$

Problemi 2**7 pikë**

Kompania CBA NNT e cila kishte filluar aktivitetin disa vite më parë, me datë 31.12.2017 kishte ketë gjendje të aseteve sipas kontabilitetit. Vetura me nr. rendor 8 konsiderohet veturë luksoze.

#	Lloji i pasurisë	Përshkrimi i pasurisë	Numri	Furnitori	Kosto e blerjes	Vlera me TVSH	Data e Blerjes
1	NDËRTESE	Lokali në Prishtinë (50m2)	001329	ABC shpk	440,000.00	519,200.00	29.09.2015
2	TOKA	Toka në Veternik (22 ari)	00288-4	FESTIM BERISHA	66,000.00	66,000.00	27.11.2017
3	PAJISJE TJERA	Rafte per Depo (1000kg)	09180003	RAFTI shpk	4,000.00	4,720.00	18.02.2016
4	PAJISJE TJERA	Klima ftohese per Depo	298	TERMOKLIMA	6,000.00	7,080.00	19.09.2016
5	MJETE TRANSPORTUESE	Opel Corsa	930/2017	AUTOMOBILI shpk	5,000.00	5,900.00	16.01.2017
6	MJETE TRANSPORTUESE	Citroen C3	91/2017	AS VETURA	6,000.00	7,080.00	06.10.2015
7	MJETE TRANSPORTUESE	PEZHO 306	222/16	ALBAN GASHI	4,000.00	4,000.00	09.10.2017
8	MJETE TRANSPORTUESE	Veture Porshe Kayenne	193-2017	AS LUKSOR	46,000.00	54,280.00	26.10.2017
9	LICENCE	Licence per DEPO 5 vjeçare #01063	010633	MINISTRIA E SHENDETSISË	5,000.00	5,000.00	27.07.2017
10	MJETE TRANSPORTUESE	KAMIONI	R 55562	GERMAN AG	18,000.00	21,240.00	27.11.2017
					600,000.00	694,500.00	

Kërkohet: Të llogaritet zhvlerësimi/ Amortizimi sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave për vitin që përfundon me 31.12.2017 ?

Zgjidhje

#	Lloji i pasurisë	Përshkrimi i pasurisë	Kosto e blerjes	Data e Blerjes	Zhvlerësimi/Amortizimi për vitin 2017
1	NDËRTESE	Lokali në Prishtinë (50m2)	440,000.00	29.09.2015	=440,000 x 5% = 22,000 euro
2	TOKA	Toka në Veternik (22 ari)	66,000.00	27.11.2017	nuk zhvlerësohet
3	PAJISJE TJERA	Rafte per Depo (1000kg)	4,000.00	18.02.2016	=4,000 x 20% = 800 euro
4	PAJISJE TJERA	Klima ftohese per Depo	6,000.00	19.09.2016	=6,000 x 20% = 1,200 euro
5	MJETE TRANSPORTUESE	Opel Corsa	5,000.00	16.01.2017	=5,000 x 20% = 1,000 euro
6	MJETE TRANSPORTUESE	Citroen C3	6,000.00	06.10.2015	=6,000 x 20% = 1,200 euro
7	MJETE TRANSPORTUESE	PEZHO 306	4,000.00	09.10.2017	=(4,000 x 20%)/2 = 400 euro (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017)
8	MJETE TRANSPORTUESE	Veture Porsche Kayenne	46,000.00	26.10.2017	= 46,000x50% = 23,000 (për qëllime të ATK-së pranohet vetëm 50% e vlerës) (23,000 x 20%) / 2 = 2,300 euro (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017)
9	LICENCE	Licence per DEPO 5 vjeçare #01063	5,000.00	27.07.2017	=5,000 / 5 vite = 1,000 /2 = 500 euro (amortizim) (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017)
10	MJETE TRANSPORTUESE	KAMIONI	18,000.00	27.11.2017	=(18,000 x 20%) /2 = 1,800 euro (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017)
			600,000.00	-	Total për vitin 2017: 31,700 euro

Problemi 3

10 pikë

Kompania MEGA për vitin që përfundon me 31.12.2017 kishte një qarkullim prej 3,000,000 Euro. Shpenzimet e përgjithshme 2,400,000 Euro.

Informacion shtesë:

Te gjitha këto shpenzime si me poshtë janë përfshirë në shpenzimet e përgjithshme me përjashtim të pikës 5.

1. Shpenzimet e zyrës prej 8,000 Euro ishin të pa mbuluar me fature 700 Euro;
2. Në kuadër të shpenzimeve të përfaqësimit prej 45,000 Euro ishin përfshirë edhe shpenzimet e marketingut në vlerë prej 10,000 Euro;
3. Shpenzimet e donacionit për këtë vit janë 35,000 Euro;
4. Shuma e zhvlerësimi të pajisjes (pajisje të rënda për largim të dheut) prej 10.000 Euro për këtë vite është zhvlerësuar në shkallën 20% edhe pse pajisja u ble në shtator të këtij viti. Pajisja i takon grupit të dytë;
5. Nuk është aplikuar zbritja e posaçme për pasurin e re (gërmuesin e dheut);
6. Gjobat e kompanisë ishin në vlerë prej 7,800 Euro;
7. Qiraja për muajin Dhjetor 2017 prej 5,500 Euro sipas marrëveshjes do të paguhet në Prill 2018; po në të njëjtin muaj do të ndalet tatimi në burim.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë MEGA shpk me 31.12.2017 ?

Zgjidhje

Të ardhurat	3,000,000
SH.P.	<u>(2,400,000)</u>
Fitimi Kontabël	600,000

Rregullimet për:

Sh. zyrës(1*)	700
Shpenz. përfaqësimit (2*)	5,000
Zhvlerësimi (4*)	5,000
Zbritja e posaçme(5*)	(5,000)
Donacioni	35,000
Gjoha(6*)	7,800
Qiraja(7*)	<u>5,500</u>
Fitimi par Donacionit(3*)	654,000
Donacioni	(35,000)
Fitimi para tatimit	619,000
Tatimi (10%)	61,900

Llogaritjet dhe sqarimet:

1* Shpenzimet zyres të pambuluara me fature prej 500 Euro (Shpenzimet e pazbritshme;

2* Shpenzimet e përfaqësimit:

45,000-10,000 (shpenzime të marketingu)=35,000 Euro

Qarkullimi 3,000,000 x 1% = 30,000 (limiti i shpenzimeve të lejuara)

Shpenzimet e përfaqësimit 35,000-30,000= 5,000 (shpenzime të pa lejuara)

4* Zhvlerësimi $10,000/2= 5,000$ (shpenzim i pazbritshem pasi që asetit është blerë në gjashtëmujorin e dytë)

5* Zbritje e posaçme për asetin e ri lejohet prej 10% e vlerës kushtuese vetëm në vitin e blerjes.

Shpenzimi i zhvlerësimit $10,000/20\%=50,000$ - Vlera e asetit sipas kostos.

$50,000 \times 10\% = 5,000$ Euro zbritje e posaçme e lejueshme.

6* Gjohat në tërësi sipas ligjit të TAK janë shpenzime të pa zbritshme.

7*Qiraja - Shpenzimet që lidhen me tatimin në burim(si në rastin tonë Qiraja) sipas Ligjit TAK nëse nuk paguhen deri me 31 Mars të vitit në vijim janë shpenzime të pa zbritshme për atë periudhë.

3* Donacioni pranohet në tërësi si shpenzim pasi që është nën limitin e lejuar nga Ligji TAK (10% e fitimit para donacionit).

Problemi 4**8 pikë**

Kompania ABC shpk ka të punësuar 2 punëtorë dhe një Menaxher. Paga e të punësuarve për muajin Janar 2018 janë si me poshtë:

Paga Neto	
Menaxheri	1,200
Punëtori 1	620
Punëtori 2	420

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit ne paga dhe KP për muajin Janar 2018 të këtyre të punësuarve (Kujdes pagat janë **neto**).

Zgjidhje**1. Menaxheri: paga Janar = 1,200**

	a	b	c=axb	d=a-c	
	Paga e tatueshme	Shkalla e tat.	Tatimi	Paga Neto	Kumulative Paga Neto
1.	80	0%	0	80.00	80.00
2. (1*)	170	4%	6.8	163.20	143.20
3. (2*)	200	8%	16	184.00	427.20
4.(3*)	858.67	10%	85.87	772.80 (3*)	1,200.00
TOTAL	1,308.67		108.67	1,200	

KP

Paga bruto $1,308.67/95\%= 1,377.54$

KP = $1,377.54 \times 5\%= 68,87 + 68.87 = 137.75$

(1*) diferenca e pages nga 80 - 250 = 170

(2*) diferenca e pages nga 250 - 450 = 200

(3*) diferenca e pages neto $80+163.20 +184= 427.20$

Paga neto e menaxherit $1200 - 427.20= 772.80/90\%= 858.67$

2. Punëtori 1: paga Janar = 620

	a	b	c=axb	d=a-c
	Paga e tatueshme	Shkalla e tat.	Tatimi	Paga Neto
1.	80	0	0	80.00
2. (1*)	170	4%	6.8	163.20
3. (2*)	200	8%	16.00	184.00
4.(3*)	214.22	10%	21.42	192.80
TOTAL	664.22		44.22	620.00

KP

Paga bruto $664.22/95\% = 699.18$

KP = $699.18 \times 5\% = 34.96 + 34.96 = 69.92$

(1*) diferenca e pages nga 80 - 250= 170

(2*) diferenca e pages nga 250 - 450= 200

(3*) diferenca e pages neto $80+163.20 +184= 427.20$

Paga neto e menaxherit $620- 427.20= 192.80/90\% = 214.22$

3. Punëtori 2: paga Janar = 420

a	b	c=axb	d=a-c
Paga e tatueshme	Shkalla e tat.	Tatimi	Paga Neto
1. 80	0	0	80.00
2. (1*) 170	4%	6.8	163.20
3. (2*) 192.17	8%	15.37	176.80
TOTAL 442.17		22.17	420.00

KP

Paga bruto $442.17/95\% = 465.45$

KP = $465.45 \times 5\% = 23.27 + 23.27 = 46.55$

(1*) diferenca e pages nga 80 - 250= 170

(2*) diferenca e pages nga 80 +163.20= 243.20

Paga neto e menaxherit $420 - 243.20= 176.80/92\% = 192.17$

	Paga Bruto	Tatimi	Pensioni	Pensioni	Paga Neto
Menagjeri	1,377.54	108.67	68.87	68.87	1,200.00
Punetori 1	699.18	44.22	34.96	34.96	620.00
Punetori 2	465.44	22.17	23.27	23.27	420.00
TOTAL	2,542.16	175.06	127.11	127.11	2,240.00

Problemi 5

5 pikë

Kompania "DARDHA" për vitin 2016 ka pasur një fitim neto 360,000 Euro dhe tatim në të ardhurat e korporatave bazuar në deklaratën përfundimtare në vlerë prej 60,000 Euro.

Parapagimi i kësteve ka qenë në shumë prej 56,000 EUR (metoda historike), diferenca prej 4,000 Euro është paguar me deklaratë përfundimtare me 31 mars 2017.

Bazuar në vendimin e menaxhmentit të kompanisë për vitin 2017 parapagimi i tatimit në të ardhurat e korporatave do të vazhdoje të paguhet bazuar në metodën e "strehës së sigurt" edhe pse është planifikuar sipas këtij buxheti se fitimi do të jetë rreth 80,000 Euro.

Kërkohet:

Sa do të jetë shuma e një kësti për vitin 2017 për Kompaninë "DARDHA".

Zgjidhje

Për periudhen vijuese të vitit 2017, paguhet së paku një e katërta (1/4) e 110% të detyrimit tatimor të përgjithshëm të periudhës paraprake (në këtë rast të vitit 2016), që rezultoi 60,000 Euro.

Kalkulimi për këstet e vitit 2017:

$$60,000 \times 110\% = 66,000 \times \frac{1}{4} = 16,500 \text{ Euro.}$$

Problemi 6

5 pikë

Pas Kontrollit nga ana e ATK-së tek kompania FLAMURI sh.p.k. për periudhën 03/2016 për Tvsh rezultojë me obligim shtesë prej 4,500 Euro.

1. Akti i kontrollit u dorëzua tek kompania së bashku me njoftim vlerësimin në Maj 2017.
2. Deklarim dhe Pagesa e Tvsh-së nga kompania për këtë periudhë kishte qenë 22,050 Euro (deklaruar dhe paguar në kohë).

Kërkohet:

Sa janë gjobat dhe interesi përkatës që aplikohen tek njoftim vlerësimi për tatimin shtesë të dal nga akti i Kontrollit bazuar në Ligjin mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore?

Zgjidhje

1. Gjopa për nën deklarim tatimor 25% e tatimit shtesë:

$$4,500 * 25\% = 1,125.00$$

2. Gjopa për mos pagese në kohë 1% në muaj (max 12 muaj):

$$4,500 * 1\% \times 12M = 540.00$$

3. Interesi 0.65 % në muaj (14 muaj) :

$$4,500 * 0.65\% \times 14M = 409.50$$

TOTAL

2,074.50

Problemi 7**10 pikë**

Koeficienti i Tvsh-së se zbritshëm për vitin 2016 për kompaninë SMART Construction Sh.P.K ishte 80%. Në Mars 2017 kompania SMART Construction kishte blerje 2,500,000 Euro; shitje vendore 4,200,000 Euro; eksport 110,000 Euro dhe shitje të përjashtuara pa të drejtë kreditimi 500,000 Euro.

Kërkohet:

- a) Cili është koeficienti që duhet të përdoret për Mars 2017 ?
- b) Sa është obligimi/kreditimi i Tvsh-së për Mars 2017 ?

Zgjidhje:

a) Koeficienti që duhet përdoret gjatë vitit 2017 përkatësisht në muajin Mars është 80%.

b) Ekstrakt i deklaratës mujore Mars 2017:

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH			
Periudha e Deklarimit:	Kolona [1]	03	2017
Numri Fiskal:	Kolona [3]	600600600	
Emri i biznesit:	Kolona [4]	SMART CONSTRUCTION	
Adresa e biznesit:	Kolona [5]	PRISHTINE, KOSOVE	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [6]	Filan Fisteku 044/123123	
		Furnizimet Vlera	TVSH
Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi	Kolona [9]	500,000	
Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi	Kolona [10]	-	
Eksportet	Kolona [11]	110,000	
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	4,200,000	756,000
		Kolona [30]	756,000
		Blerjet Vlera	TVSH
Blerjet dhe importet me TVSH jo të zbritshme	Kolona [33]	590,000	
Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	Kolona [34]	-	
Importet me normë 18%	Kolona [35]	-	-
Importet me normë 8%	Kolona [37]	-	-
Importet investive me normë 18%	Kolona [39]	-	-
Importet investive me normë 8%	Kolona [41]	-	-
Blerjet vendore me normë 18%	Kolona [43]	2,000,000	360,000
		Kolona [67]	360,000
		Kalkulimi Vlera	
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]	-	
Balanca kreditore e mbetur $69 = ((67+68)-30) > 0$	Kolona [69]	-	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues $71 = (69-70)$	Kolona [71]	-	
TVSH që duhet të paguhet $72 = (30-67-68) > 0$	Kolona [72]	396,000	

Sqarim: Blerjet dhe importet me Tvsh jo të zbritshme :

$(2,500,00 \times 20\%) = 500,000$ (pjesa e kostos)
plus(+) $2,500,000 \times 20\% \times 18\% = 90,000$ (pjesa e Tvsh-së së pazbritshme)
Total $= 590,000$

Blerjet vendore me normë 18%: $2,500,000 \times 80\% = 2,000,000$